



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:041652

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876204

KPPP.nr.914/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Raiffeisen Bank Kosovë - RBKO, me NRB:70025959, me seli në Prishtinë, rruga “Robert Doll” nr.99, kundër debitorëve 1. N.P.T. “Semir” - S.C. B.I., me NUI:810980294, me seli në Prizren, rruga “Tiranës”, 2. S.C. me vendbanim në Prizren, rruga “Tiranës”, 3. XH.C. me vendbanim në Prizren, rruga “Tiranës” dhe 4. R.C. me vendbanim në Prizren, rruga “Tiranës”, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për shtyrje të përmbartimit të lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.228/2021 të datës 10.02.2021, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpalljet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur sipas kërkesës së debitorëve 1. N.P.T. “Semir” - S.C. B.I., 2. S.C., 3. XH.C. dhe 4. R.C. për shtyrje të përmbartimit në lëndën përmbartimore sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.228/2021, të lejuar me datë 10.02.2021, nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani.
- II. HEDHET POSHTË si e palejuar kërkesa e debitorëve 1. N.P.T. “Semir” - S.C. B.I., 2. S.C., 3. XH.C. dhe 4. R.C., për shtyrje të përmbartimit në lëndën përmbartimor sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.228/2021, të lejuar me datë 10.02.2021, nga Përmbartuesi Privat Mehdi S. Reshani.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin përmbarimor P.nr.228/2021 të datës 10.02.2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumenteve të përmbarueshëm, ashtu që është urdhëruar debitori që t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 13,640.26 €, brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të këtij urdhri, së bashku me kamatën e rregullt dhe kamatëvonesën si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor kanë parashtruar prapësim debitorët 1. N.P.T. "Semir" - S.C. B.I., 2. S.C., 3. XH.C. dhe 4. R.C., ndërsa Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPP.nr.51/2021 të datës 10.11.2021, prapësimin e debitorëve e ka refuzuar si të pabazuar, ndërsa urdhrin përmbarimor e ka lënë në fuqi.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 23.11.2021, ka paraqitur kërkesë për shtyrje të përmbarimit, me arsyetimin se debitori nuk mund të përmbush borxhin e caktuar sipas urdhrit përmbarimor për shkak të një numri të rrethanave të papërshtatshme të cilat i kanë përcjell debitorët e në veçanti pandemia, i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesën e debitorëve ashtu që përmbarimi të shtyhet deri në gjysmën e vitit tjetër.

Gjykata, pas vlerësimit të kërkesës për shtyrje të përmbarimit dhe analizimit të shkresave tjera të lëndës, gjeti se kërkesa e debitorit për shtyrje të përmbarimit është e palejuar për arsyet si në vijim:

Me nenin 61 paragraf 1 të LPP-së, përcaktohet se: *"Në qoftë se debitori argumenton se zbatimi do ti shkaktoj atij dëm të pariparueshëm, organi përmbarues plotësisht apo pjesërisht do të shtyjë përmbarimin, në rastet kur është parashtruar ankesë kundër dokumentit përmbarues dhe pala ankuese i demonstroi gjykatës së shkallës së parë se ka mundësi bindëse për të qenë e suksesshme në ankesë, apo gjykatës i ka parashtruar kërkesa për të anuluar një vendim të arbitrazhit në pajtim me Ligjin për Arbitrazhin "*, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtit nen, përcaktohet se: *"Para se të vendos për shtyrje të përmbarimit, organi përmbarues do ti siguroj kreditorit të drejtën që të deklarohej në lidhje me të dhe të jep dëshmi në kundërshtim të shtyrjes "*. Tutje, sipas paragrafit 4 të po këtij neni, përcaktohet se: *"Organi përmbarues mund plotësisht ose pjesërisht ta shtyjë përmbarimin në situata kur debitori dëshmon përmes dokumenteve publike ose të vërtetuara se përmbarimi do ti shkaktoj dëm të pariparueshëm dhe jep garanci shumën e cila së paku korrespondon me shumën e kërkesës "*.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje të përmbarrimit është organi përmbarrues, përkatësisht Përmbarruesi Privat i cili ka lejuar urdhrin përmbarrimor, ndërsa përjashtimisht, në kuptim të nenit 61, pika 11, të LPP-së, gjykata është kompetente në rastet kur vepron si organ përmbarrimor dhe ka juridiksion për të vendosur për ankesë kundër urdhrit për përmbarrim.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 17 i LPP-së, lidhur me nenin 17, 18, 19, 29 dhe 391.1, pika a) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.914/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës:	2021:041652
Datë:	28.06.2024
Numri i dokumentit:	05876204